



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT**

Tiranë, më 24.02. 2025

Lënda: Njoftim për shpallje konkursi për 1 (një) vend pune për personel administrativ, me kohë të plotë në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

**DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE**

**K Ë T U**

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, gërma f, neni 67, pika 3, në Statutin e UST-së, kreu V, Neni 66, pika 1, gërma d); në Rregulloren e UST-së, neni 41 “*Personeli Administrativ*”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 21.05.2021 “*Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ në Universitetin e Sporteve të Tiranës*”, në VKM nr. 305, datë 05.04.2017 “*Për disa shtesa në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” të ndryshuar, në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 58, datë 21.12.2020 “*Mbi miratimin e kriterëve për hapjen e procedurave të konkursit për punonjës pastrimi /sanitar në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse*”, si dhe në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.08, datë 29.01.2025 “*Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimin e pagës për vitin 2025*”, shpall kriteret për 1 (një) vend pune për personel administrativ, me kohë të plotë në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si më poshtë;

- 1 (një) “**Punonjës Pastrimi/Sanitar**”, në Sektorin e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

**I. Kandidatët që do të aplikojnë për vendin e punës si “Punonjës pastrimi /sanitar” duhet të dorëzojnë këto dokumenta**

- a. Kërkesë për vendin e punës.
- b. CV
- c. Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme ose certifikatë notash për arsimin e ulët tetë (8) ose nëntë (9)-vjeçare.
- d. Dëshmi penaliteti
- e. Certifikatë e gjëndjes familjare.
- f. Raport mjeko ligjor, që vërteton aftësinë për pune.

### **Vlerësimi i Intervistës.**

1. Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 30 pikë nga intervista dhe 70 pikë nga kriteret e përcaktuara.

### **II. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit**

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të këtyre kandidatëve.

### **III. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët**

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Drejtoria, emri, mbiemri, adresa e konkurentit.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.
- Kandidatët do të njoftohen me e-mail nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit për datën e zhvillimit të intervistës.

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT**